

STATUTI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK

Kreu I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**FORMIMI I SHOQËRISË**

Neni 1

a. Sot në Tiranë në datën 8 Shkurt 2018 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" shpk, me vullnet shoqëritë tregtare". Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" shpk, formohet nga ortakët themelues:

1. **Germano Ventura**, shtetas italian, i biri i Bruno dhe Amalia, i datëlindjes 15.06.1967 lindur në Benevento, Itali dhe banues në Via Milano, 61A, San Ferdinando Calabria Itali, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte YA0862613.

2. **Saverio Gerardo Ciampi**, shtetas italian, i biri i Emilio, i datëlindjes 18.12.1968 lindur në Watford, Angli dhe banues në: C Las Higueras 1 Hyrja 22 Tenerife, Spanje, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte YA7600633.

3. **Manrico Erriu**, shtetas italjan, i biri i Attilio, i datëlindjes 15.01.1974 lindur në Cagliaria, Itali dhe banues në Calle Paises Bajes Ocean View 1;129 Tenerife Spanje, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte YA8400427.

b. Te cilet me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtëon veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyjes së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

**FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Neni 2

- Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Emërtimi i Shoqërisë është: "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK.
- Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

**SELIA E SHOQËRISË**

NENI 3

- Shoqëria tregtare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranes, Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga "Ibrahim Rrugova", Kompleksi "Green Park" Kulla 2, Kati 7.
- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Faqja 1 nga 5

4. Njësitë struktuore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjilacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.
5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

#### KOHËZGJATJA

##### Neni 4

1. Shoqëria Tregtare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., do të përbushë objektin e veprimitarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktimë të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

##### Neni 5

Objekti i shoqerise "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK do të jetë:

- ❖ Prodhimi, shitja dhe shpërndarja e produkteve të avancuara teknologjike, përfshirë menaxhimin e patentave, hulumtimet dhe studimet në fushën e inovacioneve teknologjike, duke përfshirë nanoteknologjinë, energjinë e qëndrueshme, menaxhimin qendror të kontrollit - menaxhimin e qendrave operative - menaxhimin dhe projektimin e strukturave të sigurisë dhe instalimin e pajisjeve të reja të kontrollit të sigurisë

#### TË DREJTATE SHOQËRISË

##### Neni 6

Shoqeria tregtare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., nuk per gjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimitaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne në menyre të pavarrur prej saj.

Shoqeria mund të ndryshoje emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimitarise, administratorin, sipas vendimeve qe do të marrin ortakët.

#### KAPITALI I SHOQËRISË

##### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 lekë (një qind mijë leke), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 3 (tre) kuota, kuota e njera nominale 5.000 lekë (pesë mijë leke), kuota e dyte nominale 45.000 lekë (dyzet e pese mijë leke), dhe kuota e trete me vlerë nominale 50.000 lekë (peddhjete mijë leke).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

**1. Germano Ventura**, zotëruesh i 1 (një) kuote apo 5 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

**2. Saverio Gerardo Ciampi** zotëruesh i 1 (një) kuote apo 45 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

**3. Manrico Erriu** zotëruesh i 1 (një) kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

Kapitali fillestar nuk është paguar.

#### NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

#### NENI 9

1. Perberja e kapitalit të shoqerise, fondet e krijimit të saj si dhe perdonimi e rregullimi i çdo fondi të veçante percaktohen nga Ortaket sipas të drejtave dhe detyrave të percaktuara në statut.

2. Të ardhurat e per gjitheshme të shoqerise dhe në per gjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjilacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve perkatese të rrjedhura prej tij.



NENI 10

- Shoqeria Tregetare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdon dhe e disponon ne emer te saj ne perputhe me qellimin dhe objektin e veprimitarise se shoqerise.
- Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhe me legjislacionin perkates shqiptar.
- Të gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 11

- Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
- Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllt me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
- Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga Ortaket dhe nese e kerkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakeve te saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar nuk jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato nuk jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesave te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do te behet pasi ata te pranojne permbytjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjesa te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjesa ne shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributiveve ne para dhe ne natyre apo i zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve te shoqerise mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga ekonomisti i firmes ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË  
ORTAKËRIA

NENI 16

Ortaketi e shoqerise tregtare "AIAT ARTIFICIAL INTELLIGENCE ADVANCED TECHNOLOGIES RESEARCH CENTER" SHPK., gëzojnë te gjitha te drejtat dhe marrin përsipër detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikës se Shqiperise, ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e Shoqerise.

Te drejtat dñe detyrat e Ortakeve

NENI 17

- Të marrë pjesë ne mbledhjet e Asamblesë se Ortakeve duke ushtruar te drejtën e votës se tij;
- Të paraqesë pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit;
- Të informohet mbi përbajtjen e raportit te administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
- Të përfitojë nga fitimi i shoqerise;
- Të kërkojë prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara;

KREU I TRETË  
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

- Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise, asambleja e ortakeve emeron dhe puneson administrator dhe drejtues teknik, te cilët qëndrojnë ne detyre deri sa revokohen nga shoqeria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimi i ortakeve te shoqerise.



2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Manrico Erriu**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjeter, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

#### ASAMBLEJA

##### NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

##### NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zgjelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarko jë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

#### TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

##### NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike ;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkates dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve; .
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblyne e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

##### NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

##### NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tērheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

##### NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të se cilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridikzionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.



3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimitarës së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

#### **FORCAT MADHORE**

##### **NENI 25**

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftezi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmanget me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftezi të plotësojnë detyrimet e tij për arsyen të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapércejnë këtë vështirësi.

#### **SHPËRNDARJA E SHOQËRISË**

##### **NENI 26**

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimitarës me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyen të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shume likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqérohet "nga shënim" Shoqëri në likujdim".

Mbasi bëhet njofimi i mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **BAZA LIGJORE**

##### **Neni 27**

E gjithë veprimitaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

#### **RUAJTJA E SEKRETIT**

##### **Neni 28**

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njofime sekrete që kanë të bëjnë me veprimitarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënavës dhe informatave që konsiderohen sekrete.

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

##### **NENI 29**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

##### **NENI 30**

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

##### **NENI 31**

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

#### **ORTAKET:**

Germanno Ventura

Faqja 5 Ngj.5

Saverio Gerardo Ciampi

Manrico Erriu